



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 13 Prot.

Tiranë, më 11 / 10 /2018

VENDIM

Nr. 5 , datë 11 . 10 . 2018

“PËR  
HAPJEN E PROCEDURAVE PËR KONKURIM NGA AGJENCITË E  
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR ZGJEDHJEN E AGJENCISË UNIKE PËR  
KRYERJEN E FUNKSIONIT TË MBLEDHJES SË SHPËRBLIMEVE  
(SPORTELI UNIK)”.

Në zbatim të nenit 138/1 të ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; vendimit nr.2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, Vendimit nr. 3 datë 22.6.2018 i KKDA-së “Mbi kërkesën e depozituar nga këshilli drejtues i sportelit unik-SUADA, për administrimin e së drejtës së autorit më dt. 25.05.2018”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurave për konkurim nga ana e agjencive të administrimit kolektiv për drejtimin e sportelit unik të administrimit të së drejtës së autorit- SUADA, për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve.
2. Agjencitë konkuese të licencuara, brenda datës 30.10.2018 duhet të depozitojnë në rrugë zyrtare, propozimet konkrete në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në nenin 138 të ligjit organik për të drejtën e autorit.
3. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

INES MUÇOSTEPA



SEKRETAR TEKNIK

SOFJAN JAUPAJ